



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 546/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” p.f, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF- 68898-05-15-2018, me objekt: “Blerje bojra për printera e fotokopje”, me fond limit 2.800.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Autoriteti kontraktor: Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga:”Osman Haxhiu”, Vlorë.

Ankimues “Mond Office” shpk
Adresa: Lagjia “Kushtrimi”, Rruga “Gjergj Kastrioti”, Vlorë.

Subjekte të interesuar: “Ervin Luzi” p.f
Adresa: Lagjia “Katund i Ri”, Rruga Ali Pashë Gucia”, Godina nr.5, Yrshek Kasha, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën. 1, të nenit. 63, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.05.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 68898-05-15-2018, me objekt: “*Blerje bojra për printera e fotokopje*”, me fond limit 2.800.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2 Në datën 28.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht si më poshtë:

1. “*Cartridge World*” shpk

pa ofertë

skualifikuar

2. "Interlogistic" shpk	pa ofertë	skualifikuar
3. "C.C.S" shpk	pa ofertë	skualifikuar
4. "Erison" shpk	pa ofertë	skualifikuar
5. "Ervin Luzi" p.f	2.087.300 lekë	kualifikuar
6. "Mond Office" shpk	2.418.985 lekë	kualifikuar
7. "Adastra" shpk	2.485.000 lekë	kualifikuar
8. "4 K TRADING Albania" shpk	2.500.000 lekë	skualifikuar
9. "Infosoft Office" shpk	2.626.130 lekë	kualifikuar

II.3 Në datën 04.06.2018 operatori ekonomik "Mond Office" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave.

II.4. Në datën 05.06.2018, operatori ekonomik "Mond Office" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik "Ervin Luzi" p.f, duke kërkuar skualifikimin e ofertës së tij në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Jemi njoftuar në websitin e APP, mbi klasifikimin e operatorëve ekonomikë.

Operatori ekonomik i renditur i pari në ofertë, në dijeninë tonë është një operator i panjohur në fushën e tregtimit të tonerave. Për rrjedhojë ne kemi dyshime se ky operator të ketë lidhur kontrata të ngjashme me institucione publike.

Nga një kontroll i kryer në arkivin e APP, për vitet e fundit ky operator nuk rezulton të ketë lidhur kontratë me subjekte publike, si rrjedhim kërkojmë verifikim të kontratave dhe vërtetimeve të realizimit të tyre.

Bazuar në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, përsa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ndërsa në nenin 53, pika 3, të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet se "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54, të këtij ligji."

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët

ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Ne gjykojmë se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve parashikuar nga neni 2, i Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Në DST kërkohet që: 2.3 Për kapacitetin teknik: "Furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë prej të paktën sa 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të marrësit të mallit (ku është me institucionet publike) ose kopje të faturave tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të funizuara të shoqëruar me vërtetim të marrësit të mallit (kur është me subjekte private).

Ne kemi të gjitha të dhëna të arsyeshme ose për të qënë më të saktë, ne mendojmë që operatori i renditur i pari në klasifikim, pra operatori "Ervin Luzi" nuk ka kontrata me institucione publike si rrjedhim edhe vërtetime të realizimit të kontratave, pra ai nuk ka dorëzuar vërtetime të realizimit të kontratës, ose thënë sipas DST, nuk ka dorëzuar vërtetime të marrësit të mallit, gjë që çon për rrjedhojë në skualifikimin e këtij operatori ekonomik.

Ne nuk morëm përgjigje nga institucioni Bashkia Vlorë, si rrjedhim kërkojmë që ky operator të skualifikohet, sepse oferta e tij nuk përmbush kërkesat e DST.

II.5. Operatori ekonomik ankimues "Mond Office" shpk lidhur me ankesën e tij nuk merr përgjigje nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.6. Në datën 21.06.2018, pala ankimuese operatori ekonomik "Mond Office" shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës vendimin e autoritetit kontraktor, duke parashtruar të njëjtat pretendime.

II.7. Me shkresën me nr. 5323/1 prot, datë 02.07.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 1156/2 datë 19.07.2018, me objekt "Kthim përgjigje" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mond Office” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Ervin Luzi” p.f, me arsyen se: “Ne kemi të gjitha të dhëna të arsyeshme ose për të qënë më të saktë, ne mendojmë që operatori i renditur i pari në klasifikim, pra operatori “Ervin Luzi” nuk ka kontrata me institucione publike si rrjedhim edhe vërtetime të realizimit të kontratave, pra ai nuk ka dorëzuar vërtetime të realizimit të kontratës, ose thënë sipas DST, nuk ka dorëzuar vërtetime të marrësit të mallit, gjë që çon për rrjedhojë në skualifikimin e këtij operatori ekonomik.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorë ekonomik duhet të paraqesin: “a Furnizime te mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë prej te pakten sa 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës. Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të marrësit të mallit (kur eshte me institucionet publike) ose kopje te faturave tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të funizuara te shoqeruar me vërtetim të marrësit të mallit (kur eshte me subjekte private).”.

III.1.2. Për përmbushje e kriterit të sipërpërmendur ofertuesi “Ervin Luzi” p.f ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e si më poshtë vijon:

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398717, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Komanda mbështetëse”, me objekt shitje “Bojra printeri”, pa datë, pa nënshkrim të blerësit dhe me vlerë 310.000 lekë (pa-TVSH).

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398713, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Mat), me objekt shitje “Bojra printeri”, datë 23.11.2017 dhe me vlerë 16.800 lekë (pa-TVSH).

Faturë tatimore Nr. Serial: 47352907, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Alban-person fizik”, me objekt shitje “Materiale kancelarie, boje printeri”, pa datë, pa nënshkrim të blerësit dhe me vlerë 92.500 lekë (pa-TVSH), ku vlera e artikullit “toner” është 26.065 lekë pa-TVSH.

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398730, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Berat”, me objekt shitje “Materiale kancelarie, boje printeri”, datë 12.03.2018, pa nënshkrim të blerësit dhe me vlerë 282.485 (pa-TVSH), e pashoqëruar me vërtetim të marrësit në dorëzim të mallit, ku vlera e artikullit “toner” është 55.083 lekë pa-TVSH.

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398729, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “I.E.V.P “Ali Demi”, me objekt shitje “Materiale kancelarie, boje printeri”, datë 09.03.2018, pa nënshkrim të blerësit dhe me vlerë 101.000 lekë (pa-TVSH), e pashoqëruar me vërtetim të marrësit në dorëzim të mallit, ku vlera e artikullit “toner” është 63.584 lekë pa-TVSH.

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398728, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Mallakastër”, me objekt shitje “Materiale kancelarie, boje printeri”, pa datë, pa nënshkrim të blerësit dhe me vlerë 99.000 lekë (pa-TVSH), e pashoqëruar me vërtetim të marrësit në dorëzim të mallit, ku vlera e artikullit “toner” është 34.083 lekë pa-TVSH.

Faturë tatimore Nr. Serial: 44268971, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “I.SH.M.P Qendër”, me objekt shitje “Bojra printeri”, datë 03.03.2017, e nënshkruar nga blerësi dhe me vlerë 449.000 lekë (pa-TVSH), e pashoqëruar me vërtetim të marrësit në dorëzim të mallit.

Faturë tatimore Nr. Serial: 54398710, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Adenis Kastrati-person fizik”, me objekt shitje “Bojra printeri”, datë 08.11.2017, e nënshkruar nga blerësi dhe me vlerë 332.500 lekë (pa-TVSH).

Faturë tatimore Nr. Serial: 62634001, me shitës “Ervin Luzi” dhe blerës “Autoriteti Kontrrollit Shtetëror të Eksporteve”, me objekt shitje “Bojra printeri”, datë 19.04.2018, e nënshkruar nga blerësi dhe me vlerë 181.000 lekë (pa-TVSH), e pashoqëruar me vërtetim të marrësit në dorëzim të mallit.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të

jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetëve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me furnizimet objekt prokurimi.

III.1.7. Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar si dëshmi të eksperiencës së mëparshme të ngjashme me objektin e kontratës të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e operatorit ekonomik objekt ankimimi janë dorëzuar dëshmi të furnizimeve të mëparshme lidhur me persona juridik publik si edhe persona juridik privat dhe konkretisht fatura tatimore shitjeje. Në respekt të kriterëve të veçanta të kualifikimit si edhe të nenit 27, pika 4, të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, KPP konstaton se faturat tatimore të shitjes, Nr. Serial: 54398717, 47352907 dhe 54398728 nuk provojnë eksperiencën e mëparshme, pasi nuk plotësojnë kërkesën për datën e furnizimeve të realizuara, ndërsa faturat tatimore Nr. Serial 54398713 54398730, 54398729, 44268971, 54398710, 62634001 dhe 62634001, megjithëse pasqyrojnë në disa zëra furnizime të së njëjtës natyre, vlera e tyre nuk plotëson vlerën prej 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës të parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mond Office” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Mond Office*” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF- 68898-05-15-2018, me objekt: “*Blerje bojra për printera e fotokopje*”, me fond limit 2.800.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 28.05.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Ervin Luzi*” person fizik dhe të korigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera..
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Mond Office*” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1156 Protokolli;
Datë 21.06.2018



Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha